

UDHËZIM
Nr. 36, datë 21.9.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 5.7 “Zvogëlimet e kapitalit” zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“5.7 Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve dhe që destinohet për shpërndarje ortakëve, do të konsiderohet dividend dhe do të tatohet si i tillë, por vetëm në masën që zvogëlimi i kapitalit rrjedh nga fitimet e kapitalizuara të shoqërisë dhe jo nga kontributet në para ose në natyrë të pronarëve. Shtesat e kapitalit, kontributet në para ose në natyrë të ortakëve dhe zvogëlimi i kapitalit duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe procedurat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 171, datë 25.09.2020